REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI PROKURORIAL I KOSOVËS/ TUŽILAČKI SAVET KOSOVA/KOSOVO PROSECUTORIAL COUNCIL

BULETINI MUJOR

Aktivitetet e Këshillit Prokurorial të Kosovës

Prill 2020

1. Aktivitetet e Këshillit Prokurorial të Kosovës

Mbahet takimi i 180-të i Këshillit Prokurorial të Kosovës

Prishtinë, 15 prill 2020 – Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK), nën masat e mbrojtjes nga pandemia COVID-19 dhe përmes video konferencës ka mbajtur takimin e 180-të me radhë, nën udhëheqjen e kryesuesit, Bahri Hyseni, me ç'rast janë diskutuar pikat sipas rendit të ditës.

Takimi filloi me diskutimin rreth gjendjes aktuale lidhur me pandeminë COVID-19 në sistemin prokurorial në përgjithësi dhe ndikimin e saj në punën e prokurorive, ku u tha se të gjitha objektet e prokurorive të Kosovës janë dezinfektuar. Lidhur me këtë u konstatua se sistemi prokurorial aktivitetet e veta është duke i realizuar në përputhje me masat e marra me qëllim të mbrojtjes nga pandemia COVID-19.

Gjatë këtij takimi, anëtarët e KPK-së, pas kërkesës dhe propozimit të Kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore të Prishtinës, kanë marrë vendim për caktimin e prokurores Sebahate Hoxha, udhëheqëse të Departamentit për të Mitur dhe prokurores Jehona Grantolli, udhëheqëse të Departamentit të Përgjithshëm në këtë prokurori.

Po ashtu, është miratuar Raporti i Komisionit për Vlerësimin e performancës së 6 prokurorëve me mandat të përhershëm dhe janë zhvilluar dy seanca dëgjimore, ku janë trajtuar raportet e paneleve hetimore lidhur me procedurat disiplinore ndaj dy prokurorëve.

Këshilli Prokurorial i Kosovës, gjatë këtij takimi ka shqyrtuar edhe çështje të tjera nga fushëveprimtaria e tij.

Sekretariati i KPK-së

Zyra e Drejtorit - Në kuadër të përgjegjësive administrative dhe mbështetjes për Këshillin Prokurorial të Kosovës, Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit dhe prokuroritë e vendit, Drejtori i Përgjithshëm i Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, Lavdim Krasniqi, ka zhvilluar takime të ndryshme duke iu përshtatur rrethanave të krijuara nga Covid 19, me staf të njesive sipas nevojes të Sekretariatit, prokurorive, Kryesuesin e KPK-së, Kryeprokurorin e Shtetit dhe me partnerë vendorë e ndërkombëtarë, me qëllim të fuqizimit dhe ngritjes profesionale të administratës së sistemit prokurorial për ngritjen e efikasitetit dhe efektivitetit në punë.
Ka mbikëqyrë të gjitha proceset e punës që do të realizohen nga Plani i Punës së Këshillit Prokurorial të Kosovës dhe Prokurorit të Shtetit dhe janë autorizuar dhe realizuar veprime konkrete në mbarvajtjen e punëve që lidhen me përgjegjësit dhe kompetencat ligjore.

Zyra Ligjore ka ofruar mbështetje për Zyrën e Kryesuesit, Zyrën e Drejtorit dhe njesitë e tjera të KPK-së, ka hartuar draftet e vendimeve të takimit të 180-të të Këshillit Prokurorial, ka ofruar mbështetje për Grupin punues në hartimin e draftit të Rregullores për vlerësimin e performancës së prokurorëve dhe ka trajtuar kërkesat për qasje në dokumente publike dhe adresimin e tyre te njësitet përkatëse.

Zyra për Komunikim Publik ka bërë monitorimin në baza mujore, ka hartuar komunikata dhe dokumente të tjera në bazë të kompetencave të veta, me qëllim të informimit të qytetarëve. Ka vazhduar koordinimin me Projektin holandez CILIC dhe Projektin britanik lidhur me komunikimin e jashtëm dhe brendshëm në sistemin prokurorial të Kosovës. Zyra gjatë këtij muaji ka bërë koordinimin e brendshëm me qëllim të fuqizimit të uebfaqes me materiale në gjuhën serbe dhe angleze, ndersa ka vazhduar me punën për lansimin e uebportalit të ri të sistemit prokurorial. Po ashtu është përgjigjur në interesimin e mediave, shoqërisë civile dhe qytetarëve për punën dhe aktivitetet e sistemit prokurorial.

Auditori i Brendshëm ka përfunduar auditimin dhe ka përgatitur raportin final të auditimit të Divizionit të Burimeve Njerëzore në Sekretariatin e Këshillit Prokurorial. Po ashtu, ka filluar auditimin në Divizionin e Shërbimeve të Përgjithshme në SKPK.

Zyra e Certifikimit, gjatë këtij muaji, duke u bazuar në obligimet dhe kompetencat e saj ka certifikuar 745 lëndë, ka pranuar 578 lëndë dhe ka kontrolluar 672 lëndë.

Zyra për Integrime Evropiane ka përfunduar dhe janë dërguar informata lidhur me inputin e KPK-së për nënkomitetin për drejtësi, liri dhe siguri të Komisionit Evropian. Është ofruar përgjigje në kërkesën e Zyrës së BE-së lidhur me rastet disiplinore ndaj

prokurorëve, të Ministrisë së Integrimeve Evropiane lidhur me inputin e KPK-së për Raportin për vendin që do të publikohet në qershor 2020, si dhe të Ministrisë së Drejtësisë lidhur me rastet disiplinore ndaj prokurorëve që do të raportohen në pyetësorin e CEPEJ-së.

Departamenti i Burimeve Njerëzore, Prokurim dhe Administratë ka verifikuar periudhat e vlerësimit për zyrtarët që përfundojnë punën provuese, ka evidentuar të dhëna të stafit në databazë dhe dosje fizike të personelit, ka dërguar në Thesar formularët për paga, listat për shtesa dhe kujdestaritë dhe ka evidentuar të dhëna të stafit në databazë dhe dosje fizike të personelit. Ky departament ka shpallur projektin "Mirëmbajtja dhe servisimi i pajisjeve të TI-së në sistemin prokurorial të Kosovës", "Mirëmbajtja dhe servisimi i pajisjeve të sigurisë (kamerave) në sistemin prokurorial të Kosovës", "Furnizim me materiale promocional zyrtare të dizajnuara dhe të shtypura për nevoja të sistemit prokurorial të Kosovës" dhe "Sigurimi i automjeteve të sistemit prokurorial të Kosovës përfshirë sigurimin e shëndetit në udhëtim". Ka pranuar dhe protokolluar 37 shkresa të brendshme dhe 509 fatura. Gjatë këtij muaji janë përkthyer 145 faqe.

Departamenti për Buxhet, Financa dhe Shërbime të Përgjithshme ka përgatitur Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve 2021-2023 për Këshillin Prokurorial të Kosovës. Ka përgatitur raportin financiar për periudhën janar-mars 2020. Ka përfunduar të gjitha shërbimet e përgjithshme dhe furnizimet sipas planit të përgatitur me staf të reduktuar dhe janë siguruar materialet mbrojtëse nga virusi COVID 19 për gjithë stafin e sistemit prokurorial. Ka mbikëqyrë, monitoruar dhe koordinuar çështjen e sigurisë përmes zyrtarit të sigurisë, i cili gjatë gjithë javës ka qenë prezent në punë dhe në kontakt të vazhdueshëm me të gjithë zyrtarët sipas nevojave të paraqitura. Departamenti ka shpenzuar 746 lëndë, ka regjistruar 397 lëndë dhe ka bërë zotimin e mjeteve për 219 lëndë.

Departamenti për Teknologji Informative ka bërë testimin e SMIL-it në pjesët: pranimi i dokumentit, regjistrimi dhe rishikimi i rastit, vendimet, aktin akuzues, pjesët e aktiviteteve të bashkëpunëtorëve profesionalë dhe të zyrtarëve të përkthimit, ka përgatitur manualin për përdorimin e aplikacionit, i cili mundëson mbajtjen e takimeve dhe prezantimin e materialit nga distanca. Departamenti ka prezantuar Sistemin Elektronik të Menaxhimit të Rasteve në Zyrën për Mbrojtje dhe Ndihmë të Viktimave, gjegjësisht, pjesa e regjistrimit dhe administrimit në tërësi të rasteve, shpërndarja automatike e rasteve të zyrtarët dhe gjenerimi i raporteve dhe ka zhvilluar modulin, i cili mundëson regjistrimin e buxhetit për projektet kapitale në sistemin elektronik të financave e-financat.

Njësiti për Shqyrtimin e Performancës së Prokurorive i KPK-së

Njësiti për Shqyrtimin e Performancës së Prokurorive ka hartuar format e raporteve statistikore për raportet infografike të webportalit të sistemit prokurorial, ka hartuar komentet dhe rekomandimet për plotësim ndryshimin e formave të raporteve të SMIL-it, ka hartuar një raport analitik për krahasimin e të dhënave statistikore të SMIL-it dhe raporteve që pranohen nga prokuroritë në formë fizike dhe ka plotësuar matrica për rastet e korrupsionit për vitin 2019 për Strategjinë e SEE-së.

Po ashtu, Njësiti ka përgatitur raportet statistikore për tremujorin e parë të vitit 2020, për rastet penale me kryerës madhorë, të mitur dhe kryerës të panjohur. Po ashtu, ka përgatitur raportet statistikore për rastet që kanë të bëjnë me raportimet për integrime evropiane për Ministrinë e Integrimeve Evropiane, për Zyrën e Koordinatorit për Krime Ekonomike, raporte statistikore për organizata të shoqërisë civile, siç janë: Fol, Çohu dhe IKD, ndërsa ka përgatitur edhe informata dhe raporte më të dhëna statistikore sipas kërkesave të ndryshme, nga persona fizikë dhe studentë të niveleve të ndryshme të studimeve.